



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

U D H Ë Z I M

Nr. _____, datë _____. _____. 2026

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJES DHE MËNYRËS SË
DORËZIMIT TË DEKLARATËS SË VEPRIMTARISË SË LOBIMIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr. 12/2026, datë 28.01.2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

U D H Ë Z O N:

1. Miratohet formulari standard “Deklarata e veprimtarisë së lobimit”, sipas Aneksit A, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Deklarata e veprimtarisë së lobimit paraqitet sipas këtij formulari.
2. Formulari standard “Deklarata e veprimtarisë së lobimit” plotësohet në mënyrë të plotë, të saktë dhe të lexueshme dhe nënshkruhet nga lobisti ose nga personi i autorizuar ligjërisht për ta përfaqësuar atë. Lobisti mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të deklaruara.
3. Kur deklarata e veprimtarisë së lobimit është e paplotë ose përmban mospërputhje me të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Lobimit, Komisioneri njofton lobistin për plotësimin ose korrigjimin e saj, duke përcaktuar mangësitë ose pasaktësitë që duhet të plotësohen ose korrigjohen.
4. Lobisti plotëson ose korrigjon deklaratën dhe e riparaqet atë pranë Komisionerit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.
5. Lobisti paraqet deklaratën e veprimtarisë së lobimit çdo 6 (gjashtë) muaj, në përputhje me nenin 18, pika 1, të Ligjit. Për efekt të administrimit të Regjistrit të Lobimit, periudhat e raportimit janë **1 janar – 30 qershor** dhe **1 korrik – 31 dhjetor** të çdo viti kalendarik. Deklarata paraqitet pranë Komisionerit brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga përfundimi i secilës periudhë raportimi. Për lobistin që regjistrohet gjatë një periudhe raportimi, deklarata e parë përfshin vetëm periudhën nga data e regjistrimit deri në përfundimin e periudhës përkatëse të raportimit.
6. Deklarata e veprimtarisë së lobimit paraqitet pranë Komisionerit:
 - a) nëpërmjet sistemit elektronik të Regjistrit të Lobimit, kur infrastruktura teknike e mundëson;
 - b) fizikisht pranë zyrës së protokollit të Komisionerit;
 - c) nëpërmjet shërbimit postar.

7. Deri në vënien në funksion të sistemit elektronik të Regjistrimit të Lobimit, deklarata paraqitet në formë elektronike, në adresën zyrtare të postës elektronike të Komisionerit, nëpërmjet shërbimit postar ose fizikisht pranë zyrës së protokollit të Komisionerit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Aneksi A “Deklarata e veprimtarisë së lobimit” është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

ANEKSI A: DEKLARATA E VEPRIMTARISË SË LOBIMIT

Periudha e raportimit:

☐ 1 janar – 30 qershor

☐ 1 korrik – 31 dhjetor

Viti: _____

I. TË DHËNAT E LOBISTIT

Fusha	Për t'u plotësuar
Emri / Mbiemri	
Subjekti	
NIPT (nëse ka)	
Adresa	
E-mail	
Telefon	

II. PËRFITUESI I LOBIMIT

Fusha	Për t'u plotësuar
Emri i përfituesit	
Lloji i përfituesit (Person fizik / Person juridik)	
Adresa	

III. VEPRIMTARIA E LOBIMIT

Numri total i veprimtarive të lobimit të zhvilluara gjatë periudhës së raportimit: _____

Fusha	Për t'u plotësuar
Përshkrimi i veprimtarisë së lobimit	
Qëllimi i veprimtarisë	
Akti, dokumenti ose procesi vendimmarrës, objekt i veprimtarisë së lobimit, kur është i identifikueshëm	
Subjekti në emër të të cilit është kryer lobimi	

Shtoni rreshta sipas numrit të veprimtarive të lobimit të zhvilluara gjatë periudhës së raportimit.

IV. KONTAKTET LOBUESE

Numri total i kontakteve lobuese të zhvilluara gjatë periudhës së raportimit: ____

Fusha	Për t'u plotësuar
Institucioni publik	
Zyrtari publik	
Funksioni	
Forma e kontaktit (Takim / E-mail / Telefonatë / Shkresë / Aktivitet publik / Tjetër)	
Data	
Vendi	

Shtoni rreshta sipas numrit të kontakteve të zhvilluara gjatë periudhës së raportimit.

V. BURIMET FINANCIARE

Fusha	Për t'u plotësuar
Burimet financiare të planifikuara për lobim	
Vlera e fondeve të planifikuara për lobim	
Burimi i fondeve	
Mbështetje financiare nga palë të treta (Po/Jo)	
Nëse po, specifiko	

VI. SHPENZIMET GJATË PERIUDHËS SË DEKLARUAR

Fusha	Për t'u plotësuar
Vlera totale e shpenzimeve të realizuara për lobim gjatë periudhës së deklaruar	
Përshkrim i përgjithshëm i shpenzimeve (opsionale)	

VII. DOKUMENTE SHOQËRUESE (nëse ka)

Fusha	Për t'u plotësuar
Lista e dokumenteve (nëse ka)	

VIII. DEKLARIMI

Fusha	Për t'u plotësuar
Deklaroj se informacioni i paraqitur është i saktë, i plotë dhe i vërtetë.	

IX. NËNSHKRIMI

Fusha	Për t'u plotësuar
Emri / Mbiemri	
Data	
Nënshkrimi	